



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 11

Tiranë – E hënë, 11 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 2025, datë 6.4.2016	Kërkesë për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Vlerësimi i përfituesve aktualë të NE-së dhe i nivelit të mirëqenies së tyre në zonat pilot”..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 4797, datë 6.4.2016	Njoftim për shitje..... 5

**KËRKESË****Nr. 2025, datë 6.4.2016****PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE (SAMP)**

05 prill 2016

PËR SHPREHJE INTERESI**SHËRBIME KONSULENCE**

PËR VLERËSIMIN E PËRFTUESVE AKTUALË TË NE-së DHE TË NIVELIT TË MIRËQENIES SË TYRE NË ZONAT PILOT - REF. NO. SAMP/CS/CQ/04-2015 KOMPANI KONSULENTE LOKALE

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**Hua nr. 8141 - AL****Nr. i identifikimit të projektit P122233**

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (shërbimi) përfshin “*Vlerësimin e përfituesve aktualë të NE-së dhe të nivelit të mirëqenies së tyre në zonat pilot*”.

Qëllimi i këtij shërbimi është që të kontrollojë/të verifikojë saktësinë e informacionit të dhënë nga aplikantët/përfituesit e NE-së në aplikimin e tyre, si dhe për të njohur më mirë karakteristikat e familjeve përfituese.

Në bashkëpunim të ngushtë me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Përkujdesjes Shoqërore dhe Shërbimeve të Integruara në MMSR, kompania lokale do të jetë përgjegjëse për auditimin e statusit aktual të përfituesve të NE-së në zonat pilot dhe nivelit të mirëqenies së tyre nëpërmjet verifikimit të kushteve të jetesës së familjeve bazuar në informacionin e dhënë në formularin e tyre të aplikimit. Pra, studimi (nëpërmjet një sondazhi) do të mbledhë kryesisht informacionin që është dhënë në formularin e aplikimit, por, gjithashtu, mund të mbledhë disa informacione shtesë për të kuptuar më mirë karakteristikat/nivelin e mirëqenies së përfituesve.

Kompania lokale pritet që të përfundojë me sukses auditimin për fazën pilot. Lista e mëposhtme e detyrave do të jetë në dialog të vazhdueshëm me MMSR-në dhe përbëhet nga këto aktivitete kryesore: i) hartimi i metodologjisë

për anketimin e familjeve; ii) zhvillimi i pyetësorëve për anketimin e familjeve bazuar në informacionin e përfshirë në formularin e aplikimit dhe informacionin shtesë të nevojshëm për të kuptuar më mirë karakteristikat/nivelin e mirëqenies së përfituesve; iii) të jetë në dialog të vazhdueshëm me MMSR-në; iv) të zbatojë të gjitha aspektet e aktiviteteve të mbledhjes së të dhënave (d.m.th. e anketës familjare); dhe v) të analizojë të dhënat dhe të përgatisë gjetjet dhe konkluzionet në bashkëpunim/konsultim me INSTAT-in lidhur me faktin nëse NE-ja ka shkuar te grupi i synuar i familjeve të varfra.

Kjo detyrë do të kërkojë një konsulent (kompani lokale) me njohuri solide të praktikave më të mira lokale në anketimet sociale dhe përvojë të dëshmuar në kryerjen e investigimit apo sondazheve të krahasueshme.

Për kryerjen e këtij shërbimi kompania do të duhet të angazhojë anketues të kualifikuar, personel për regjistrimin e të dhënave, kontrollorë cilësie, metodistë dhe analistë.

Kualifikimet e veçanta që duhet të përmbushen nga konsulenti si një entitet janë:

- duhet të ketë eksperiencë të dëshmuar në ndërmarrjen e detyrave të vlerësimit;
- duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor me përvojë të konsiderueshme;
- duhet të jetë një subjekt juridik i cili punëson një staf të paktën prej 10 punonjësish;
- duhet të punësojë dy ose më shumë vlerësuese të licencuar dhe të regjistruar;
- të ketë realizuar me sukses projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për sektorin privat dhe atë publik;
- duhet të ketë kapacitete logjistike për të kryer sondazhin brenda afatit të studimit.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (PMT), fton të gjitha kompanitë konsulente të pranueshme (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet. Kriteret e shortlistimit dhe të vlerësimit janë:



1. Eksperienca specifike e firmës në fushën e sondazheve në sektorin social	30 pikë
2. Numri i shërbimeve/kontratave të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit	30 pikë
3. Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimi i ekspertëve kryesorë	40 pikë
TOTALI	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (udhëzuesi i konsulencës)- version i janarit të 2011-s.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të forcuar kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” – CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimit e konsulentëve (botimi i janarit 2011). Kohëzgjatja e shërbimit do të jetë brenda një periudhe 4-mujore.

Kompanitë që kanë shprehur interes për këtë shërbim gjatë publikimit të parë nuk është e nevojshme të përsëritin aplikimin e tyre. Prezantimi i tyre do të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të shprehjeve të interesit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **19 prill 2016**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
– kati 1
Rruga e Kavajës, nr. 53, Tirana,
ALBANIA

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Gjergj Teneqexhiu



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 4797, datë 6.4.2016

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje si më poshtë:

SHOQËRITË HUAMARRËSE, ADMINISTRATORI:

1. Në pronësi të shoqërisë “VEFA” sh.p.k., në administrim

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Apartament banimi 2+1	Lagjja “24 Maji”, rruga e re (te Kisha), Vlorë	3 010 000	3 010 000	0	86	86	3.5.2016	11:00	DDPP
2	TRUALL	Lagjja “Ish-Ndërmarrja Ushqimore e Fierit”, Fier	98 210 000	0	98 210 000	14 030	14 030	3.5.2016	11:30	DDPP
3	Ish-Spektori i Përpunimit Drurit, Zavalone (4 objekte)	Fshati Zavalinë, Komuna Gjinar, Elbasan	4 000 000	3 660 000	340 000	650.8	542.9	3.5.2016	12:00	DDPP
4	Ish-Fabrika e Sallamit dhe Magazinë Prodhimi	Ish-zona e SMT-së, Përmet	6 500 000	5 400 000	1 092 000	728	720	3.5.2016	12:00	DDPP
5	Apartament banimi 2+1 Nr. pasurie 15/54+3-8	Lagjja “24 Maji”, rruga e re, te Kisha, Vlorë	3 100 000			86	86	3.5.2016	13:00	DDPP
6	Magazinë mish, lesh, lëkurë	Çorovodë, lagjja “Çlirim”, Skrapar	1 300 000	400 000	900 000	600	394	3.5.2016	13:30	DDPP

1. Në pronësi të shoqërisë “M. LEKA” sh.p.k., në administrim

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Truall	Tiranë	17 120 000	0	17 120 000	214	214	3.5.2016	09:00	DDPP
2	Ndërtesë dhe Truall	Tiranë	35 196 000	17 395 560	17 800 461	311.6	69.3	3.5.2016	09:30	DDPP



1. Pronësi të shoqërisë “Kamberi”

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Njësi tregtare	Lagjia “Kushtrimi”, rr. “Rakp Malile”, Vlorë	4 200 000			42	42	3.5.2016	10:00	DDPP
2	Ish-pularia	Fshati Grize, Patos, Fier	12 244 829	11 553 204	691 625	1375	372	3.5.2016	10:30	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016